



Këto vitet e tranzicionit gjuha shqipe ka pësuar deformime të llojllojshme. Një "kontribut" në këtë drejtim kanë dhënë dhe japin shumë politikanë, qeveritarë e gazetarë të mjeteve të shkruara dhe elektronike të informimit, që nuk kanë kulturë të mjaftueshme gjuhësore, për të mos folur për një kulturë të përgjithshme të cunguar.

Në këtë artikull do të mundohemi që, me ca shembuj të thjeshtë, të tregojmë disa nga llojet e deformimeve që hasen më shpesh.

Një nga deformimet më të rëndomta është përdorimi pa nevojë, e madje disa herë edhe në mënyrë të gabuar, i një numri të madh fjalësh të huaja, të tilla si: "implementim" (në vend të "zbatim", "futje", "vënie në jetë"), "impakt" (në vend të "ndikim"), "surprizohem" (në vend të "befasohem"), "konsideroj" (në vend të "marr parasysh"; p.sh.: "e konsideroj këtë fakt", në vend të "e marr parasysh këtë fakt"), "anunçoj" në vend të "njoftoj" ("lajmëroj", "kumtoj", "shpall", sipas rastit), "impresion" në vend të "përshtypje" ("mbresë"), "previzion" në vend të "parashikim", "dipendohet" në vend të "varet", "resurse" në vend të "burime", "trend" në vend të "prirje" (p.sh.: prirjet e zhvillimit të vendit), "të detajshme" në vend të "të hollësishme", "në mënyrë frekvente" në vend të "shpesh" ("shpeshherë"), "aggravim" në vend të "rëndim" (i gjendjes, sëmundjes), "abdejtoj" në vend të "përditësoj" ose "freskoj" apo "rifreskoj", "është involvuar" në vend të "është përfshirë", "abandonoj" në vend të "braktis" etj., etj. Madje, disa herë renditen njëra pas tjetrës në të njëjtën fjali fjala shqipe me të huajën përgjegjëse; p.sh., thuhet "një ndikim dhe një influencë", apo "një përvojë dhe një eksperiencë" etj.

Disa fjalë të huaja që janë bërë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe, shqiptohen gabim, shpesh duke ndërruar edhe vendin e tingujve. P.sh., thuhet "martenitet" në vend të "maternitet" (amësi, lindje, shtëpi lindjeje), "infakt" apo "infrakt" në vend të "infarkt" (mbyllje e enëve të gjakut), "boljer" apo edhe "buljer" në vend të "boiler" (zierës apo ngrohës uji), "andresë" në vend të "adresë", "ventratë" në vend të "vetratë" ("xhamllëk"), "prespektivë" në vend të "perspektivë", "korrespondent" në vend të "korrespondent" etj. Në raste të tjera, fjalëve të vendit ose të huaja u shtohen tinguj, më shpesh në fund, por edhe në mes. Për shembull, thuhet "Yzberisht", në vend të "Yzberish" apo "garazhd" në vend të "garazh" (ngatërrohet garazhi me grazhdin, ku u hidhet

ushqimi kafshëve), ose fjalës "zvicëran" i shtohet një "i" dhe ajo shqiptohet e shkruhet gabimisht "zvicërian".

Në fjalë të tjera zëvendësohet një shkronjë a një tingull me një tjetër. Për shembull, shkruhet e thuhet "albitër" në vend të "arbitër", "dakort" (në akord) në vend të "dakord", "eliminim" në vend të "eliminim", "energjitike" në vend të "energjetike", "dokumenta" në vend të "dokumente", "denancim" në vend të "denoncim", "difekt" në vend të "defekt" (d-efekt) etj. Te mjaft emra njerëzish i-ja zëvendësohet në të shkruar me j, si p.sh., shkruhet "Arjan" në vend të "Arian", "Marjana" në vend të "Mariana" etj. Dhe kur gabime të tilla bëhen në shkrimin e emrave të përveçëm apo të familjeve në dokumente shtetërore identifikimi, kjo sjell pasoja tepër të pakëndshme për qytetarët.

Disa fjalë që kanë hyrë në gjuhën shqipe dhe që kanë c ose g të ndjekur nga një e ose i, shkruhen gabimisht me ç përkatësisht me xh ose me g, në vend që të shkruhen me c përkatësisht me gj, sipas drejtshkrimit të shqipes standarde. Kështu, shkruhet "çertifikatë" në vend të "certifikatë", "proçes" në vend të "proces", "koefiçient" në vend të "koeficient", "defiçit" në vend të "deficit", "liçensë" në vend të "licencë" etj.; "dixhital" në vend të "digjital" (shifror), "axhenda" në vend të "agjenda" dhe "gen" në vend të "gjen", kur shkenca përkatëse shkruhet "gjenetika".

Një grup tjetër gabimesh janë ato që kanë të bëjnë me shtrembërimin e kuptimit të fjalëve, për shkak të njohjes së mangët të leksikut të shqipes apo të gjuhëve të huaja. I tillë është përdorimi i një fjale në vend të një tjetre me kuptim të afërt, por jo të njëjtë. Kështu, dëgjojmë të thuhet e të shkruhet që "u inaugurua" (në vend të "u përrua") busti i Nënë Terezës apo ai i Lasgush Poradecit, kur ato janë shtatore (statuja). Ndodh edhe më keq, kur në një artikull gazete përdoren të dy termat për të njëjtin objekt skulpturor. Po t'u referohemi fjalorëve, busti është një skulpturë që paraqet pjesën e sipërme të trupit të njeriut që nga mesi e lart ose kokën dhe një pjesë të krahavorit dhe jo të gjithë trupin, si shtatorja. Një gabim i të njëjtit lloj bëhet në disa reklama televizive kur flitet për lavaman (duarlarëse) dhe paraqitet lavapjata (pjatlarëse).

Shumë njerëz ngatërrojnë fjalë të afërta nga ana fonetike, por krejtësisht të ndryshme nga ana kuptimore, si: adaptoj (përshtat) dhe adoptoj (1. birësoj; 2. pranoj; p.sh. një rezolutë, një vendim etj.); stimuloj (nxit) dhe simuloj (shtirem); mëshiroj (ndjej mëshirë për dikë, i fal gabimin) dhe mishëroj (shpreh diçka në trajtë konkrete, e trupëzoj: p.sh. mishëroj në art një ide); mostër (gjedhe; p.sh. mostër gjaku, dheu, minerali, stofi etj.) dhe monstër (përbindësh); njësoj (bashkoj në një të vetme, unifikoj) dhe njehsoj (llogarit, bëj veprime me numra); afroj (e çoj më afër, më pranë) dhe ofroj (bëj ofertë, propozoj; p.sh. ofroj një çmim, një mundësi etj. dhe jo afroj...); klimatike (që ka të bëjë me klimën; p.sh.: kushtet klimatike) dhe klimaterike (që ka klimë të mirë për shëndetin; p.sh.: vend klimaterik apo qendër klimaterike), "përshtoj" (kaloj nga njëra anë në tjetrën etj.) dhe "përshtuaj" (paraqit me shkrim a me gojë tipare, dukuri a rrethana të ndryshme) etj.

Për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës së huaj, disa herë bëhen përkthime të gabuara të disa fjalëve. P.sh., në italishte karboni si element quhet carbonio, kurse qymyri carbone. Duke i ngatërruar këto dy fjalë, rëndom dëgjojmë në emisionet e lajmeve që të thuhet "minierë karboni", në vend të "minierë qymyri". Në raste të tjera, shkak i këtyre gabimeve është mosnjohja e leksikut abstrakt të shqipes. Kështu, fjala angleze "approach" shpesh përkthehet

"përqasje", që do të thotë "krahasim", në vend të "qasje", që në kuptimin kryesor do të thotë "mënyra si bëhet diçka; nga kapet diçka për ta bërë a për ta zgjidhur". Disa herë fjala "avantazh" në vend që të shqipërohet "epërsi", përkthehet gabimisht "përparësi" (që është sinonim i "prioritet"-it).

Një gabim që bëhet shpesh, sidomos nga gazetarët, është që disa fjalëve të huaja, që kanë hyrë në shqipe me një a dy valenca gjuhësore, u jepen edhe valenca të tjera, si në gjuhët e huaja. Për shembull, termi "argument" në gjuhën shqipe ka si kuptim kryesor "një arsyetim që përdoret për të vërtetuar ose për të kundërshtuar një mendim", mirëpo, në ndikimin e disa gjuhëve të tjera, në shumë emisione lajmesh thuhet që "kalojmë në një argument tjetër", kur duhet të thuhet që "kalojmë në një temë tjetër". Po kështu, fjala "develop" përkthehet nga anglishtja pothuajse gjithmonë "zhvillim", kur ajo, sipas rastit e rrethanave, duhet të përkthehet edhe me disa fjalë të tjera, si "hartoj" (një program, një projekt etj.), "shtjelloj" (një temë, një mendim), "përsos" (diçka), "përhapet" (një sëmundje a epidemi), "shfrytëzoj" (një minierë), "sqaroj", "zbuloj" a "bëj të qartë" (një fakt), "ndërtoj", "përpunoj" etj.

Në mjaft raste vërehet përdorimi i gabuar i disa fjalëve në shoqërimi të caktuara fjalësh. Kështu, përdoret rëndom togfjalëshi "për arsye sepse", kur duhet thënë "për arsye se", togfjalësh që është i barabartë me "sepse". Pra, duhet thënë "nuk erdha për arsye se..." ose, që është njësoj dhe më shkurt, "nuk erdha sepse...", dhe jo "nuk erdha për arsye sepse...". Po kështu, edhe togfjalëshi "për faktin sepse", që nuk është në natyrën e shqipes, duhet zëvendësuar me lidhëzën "sepse". Me ndajfoljen "sepse" rëndom bëhet edhe një gabim tjetër. P.sh., për të lajmëruar mosardhjen, thuhet: "ju njoftoj sepse nuk do të vij", kur duhet thënë: "ju njoftoj se nuk do të vij".

Gabohet shpesh edhe në të folur, edhe në të shkruar në përdorimin e përemrit "kush", i cili duhet të përdoret vetëm për njerëz e jo për sende, i pashoqëruar me emra dhe vetëm në numrin njëjës. P.sh., duhet pyetur "kush e shkroi?", duke kuptuar një njeri dhe jo "kush gazetë e shkroi", po "cila gazetë e shkroi"; duhet shkruar "cili faktor ndikoi" dhe jo "kush faktor ndikoi" etj.

Gabime të shumta bëhen në përdorimin e formave gramatikore, si me gjinitë e emrave apo me trajtat e shkurtra të vetorëve etj. Dihet se disa klasa emrash mashkullorë e ndërrojnë gjininë në shumës dhe që përcaktorët (mbiemrat dhe përemrat) që i shoqërojnë, në shumës vihen në gjininë femërore. Emra të tillë janë ata që e bëjnë shumësin me prapashtesat "e" dhe "ra". Mirëpo shpesh dëgjojmë, p.sh., që të thuhet "talente të rinj", "shkrime të tjerë", "personazhe publikë", "shira të rrëmbyeshëm", "këta tre male të lartë", në vend të "talente të reja", "shkrime të tjera", "personazhe publike", "shira të rrëmbyeshme", "këto tri male të larta", përkatësisht. Një gabim i ngjashëm bëhet me fjalën "element", e cila shumësin zakonisht e bën me "e", me përjashtim të rasteve kur flitet për njerëz, në të cilat e bën me "ë". Pra, duhet të thuhet, p.sh., që "janë kapur disa elementë të rrezikshëm kriminalë", por që "karboni dhe squfuri janë elemente kimike".

Nga ana tjetër, u ndërrohet në mënyrë të gabuar gjinia përcaktorëve të disa emrave mashkullorë që nuk përfshihen në dy klasat e mësipërme. Kështu, thuhet "këto tituj", "ato burra", "këto politikanë", "lekë të reja", "objektiva të qarta" etj., kur duhet të thuhet "këta tituj", "ata burra", "këta politikanë", "lekë të rinj", "objektiva të qartë". Shmangie në lidhje me gjininë vërehet edhe në përdorimin e përemrit pronor "ynë", që shoqëron emrat e gjinisë mashkullore.

Ai pothuajse është hequr nga përdorimi, ngaqë shumica e njerëzve thonë "populli jonë", "vendi jonë", në vend të "populli ynë", "vendi ynë" etj.

Te deformimet që i bëhen gjuhës shqipe mund të ndalesh gjatë, pasi ato janë të shumta. Fakti që gabime gjuhësore gjenden me shumicë edhe në ligjërimin e njerëzve publikë, të cilët supozohet të kenë një nivel të lartë kulturor, tregon se kultura gjuhësore te ne është përgjithësisht e nivelit të ulët, gjë që kërkon vëmendje dhe masa nga ana e organeve dhe e institucioneve përkatëse, duke filluar nga ato arsimore. Nga ana tjetër, edhe vetë personat publikë (dhe jo vetëm këta), sidomos gazetarët, duhet të bëjnë përpjekje vetjake për rritjen e kulturës së tyre gjuhësore, duke e quajtur atë si pjesë përbërëse të kulturës së vet profesionale.

Marrë nga gazeta: Metropol